



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 689, datë 14.10.2025

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...}
NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative; në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; në pikën 7, 10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 261, datë 14.05.2025, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë të cilat ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale për të cilat ka filluar shqyrtimi, me të pandehur që ndodhen në masat e sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest shtëpie”, si edhe të gjitha çështjet ku është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.
3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2025.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR